

VENDIM
Nr. 8, datë 16.3.2015

PËR FILLIMIN E PROCEDURAVE HETIMORE ADMINISTRATIVE

Në mbështetje të nenit 14 dhe të nenit 27 të ligjit nr. 8102, datë 28.03.1996 "Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura", të ndryshuar, dhe nenit 80 e vijues i Kodit të Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë, Komisioni Kombëtar Rregullator

VENDOSI:

1. Të nisë procedurën hetimore për marrjen e masave administrative për kundërvajtjen administrative "Ushtrimi i veprimtarisë pa licence", ndaj operatorëve:

- a) Shoqëria "Ujësjetllës-Kanalizime Kukës" sh.a.;
- b) Shoqëria "Ujësjetllës-Kanalizime Fushë-Arrëz" sh.a.;
- c) Shoqëria "Ujësjetllës Has" sh.a.

2. Shoqëritë e përmendura në pikën 1 të këtij vendimi të njoftohen dhe të thirren për t'u dëgjuar mbi objektin e procedimit, sipas grafikut bashkëlidhur.

3. Ndjek zbatimin e këtij vendimi sektori juridik dhe marrëdhënieve me publikun.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Avni Dervishi